



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare
Senca nr.2003/11
Prishtinë, më 10 prill 2003, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla plenare

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit të Kosovës , kurse bashkëkryesues ishte **Xhavit Haliti**, antarë i Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se ne seancë ishin të pranishëm 85 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj sence , si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit i senacës së mëparshme ,
2. Shqyritmi i raportit për personat e humbur dhe të kidnapuar ,
3. Shqyritmi i raportit për gjendjen në gjyqësinë e Kosovës ,
4. Shqyrtimi i parë i P/Ligjit për kooperativat bujqësore ,
5. Shqyrtimi i propozimeve për emrimin e disa anëtarëve në komisionet e Kuvendit
6. Mendimi i Komisionit për Çështje Gjyqësore , Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me mocionin e deputetit Arsim Bajrami ,
7. Parshtrimi i pyetjeve ,
8. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare më 17 prill 2003 .

Kryesuesi kërkoi që pika e katërt e rendit të ditës të mos shqyrtohet në këtë seancë. Ky propozim u miratua nga deputetët.

1. Miratimi i proceverbalit i seancës së mëparshme .

Nuk pati vërejtje në procesverbalin e seancës së mëparshme dhe ai u miratua.

2. Shqyrtimi i raportit për gjendjen në gjyqësinë e Kosovës.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me raportin për gjendjen në gjyqësinë e Kosovës.

Arsim Bajrami tha se gjendja aktuale në gjyqësinë e Kosovës është e përcjell me kundër thënie të shumta juridike e faktike që e vënë në pikëpyetje pavarësinë e gjyqësisë kosovare.

Ai veçoi pesë probleme kryesore me të cilat ballafaqohet sistemi i gjyqësisë në Kosovë.

a. Mungesa e ligjeve adekuate në fushën e gjyqësisë . Ende vazhdohet të aplikohen ligjet e një shteti , i cili juridikisht dhe faktikisht është shpërbërë dhe paraqet një absurd juridik të panjohur në praktikën ndërkombëtare.

b. Problemi i dytë me të cilën ballafaqohet sistemi i gjyqësisë në Kosovë është politika kadrovike që kryesisht mbulohet me kuadra të para vitëve nëntëdhjeta edhe pse pas asaj kohe janë përgatitur mjaft juristë me një legjislacion të ri po që nuk kanë arritur të punësohen në gjyqësinë kosovare .

PSSP- ka emruar gjyqëtarë dhe preokurore që kanë qenë të involvuar në praktikat diskriminuese në të kaluarën .

c. Problemi i tretë është dilema se a kemi apo s'kemi gjyqësi të pavarur në Kosovë?

Fatëkeqësisht nuk mund të flasim për një gjyqësi të pavarur, theksoi z.Bajrami. Gjyqësia vazhdon me recidivat e sistemit komunist dhe vazhdon të ndikohet në të politikisht me mekanizmat e kontrollit politik që po e ushtron UNMIK-u.

d. Gjendja materiale dhe kadrovike në gjyqësinë e Kosovës. Sistemi i gjyqësisë ende nuk është polotësuar me kuadrat e nevojshme profesionalë. Gjendja materiale poashtu është e disfavorshme, gjyqëtarët dhe prokuroret tanë marrin paga të ulëta dhe kanë probleme sigurie.

e) Bartja e kompetencave në fushën e gjyqësisë .

Zylfije Hundozi tha se Grupi parlamentar i AAK-së, e përkrah rekomandimin e Grupit të punës lidhur me gjendjen në gjyqësinë e Kosovës. Ajo që më së shumti e rëndon situatën në gjyqësinë e Kosovës, shtoi znj. Hundozi është mungesa dhe mosdefinimi i qartë i vlerësimit dhe i trajtimit të personave që konsiderohen të papërgjegjshëm në momentin e kryerjes së veprës penale .

Për veprat penale të bëra , këta persona trajtohen në Klinikën e Neuropsikikoatrisë, e cila, sipas saj është shëndrruar në burg. Në atë klinikë nuk ka kushte as për pacient të cilët trajtohen në te dhe vetë prezenca e forcave policore zgjon asociacione negative të pacientëve prezent. Nga ana e gjyqit nuk ekziston kërkesë e posaçme që të vlerësohet në mënyrë konzulare gjendja mendore e tyre, por ashtu si i konvenon secilit gjykatës e gjenë psikiatrin me të cilin bashkëpunon dhe kryen punën më lehtë. Kështu që është hapur rruga për vlersime subjektive të situatës dhe gjendjs mendoretë kryesit të veprës penale në momentin e krimit si dhe keqpërdorimit të situatës së krijuar që dëmton gjyqësinë dhe